



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.120/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTENEWS KOSOVA, paraqitur kundërsbjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të vendosjes së posterave të subjektit politik në afërsi të shkollës, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Birn dhe Internews Kosova me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Kosova Demokratik Turka Partisi (KDTP), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### A r s y e t i m

Me datën 04.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTENEWS KOSOVA me të cilën pretendon se me datën 03.10.2017 kan hasur dhe kanë vërejtur se në në lagjen Kurilla të Prizrenit në afërsi të shkollës fillore “Motrat Qiriazhi” janë vendosur poster të subjektit politik KDTP. Parashtruesi i ankesës thekson se objekti në fjalë gjindet në afërsi rreth 25 metra me shkollën dhe se i njëjti edhe e ka hapur zyrën e tij ku asnjë nxënës i kësaj shkolle nuk mund të hyjë dhe të dalë nga shkolla pa kaluar përskaq posterave politik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik KDTP ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 85 par 1 dhe nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD dhe fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik KDTP, në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2017, thekson se zyra e përmendur në ankesë është zyre e deputeteve të KDTP-së dhe se e njëjta është në funksion qe 5 vite dhe se të njëjtit nuk janë në dijeni se është ndonjë shkelje ligjore. I njëjti në përgjigje në ankesë njofton se kanë larguar posterat nga nga zyret e partisë por se në lidhje me këto presin edhe interpretim ligjor dhe udhëzime për këtë zyre të deputetëve si mund të veprojnë në të ardhmen si parti politike lidhur aktivitetet zgjedhore partiake.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e parashtruesit se subjekti politik KDTP duke vendosur postera të saj në afërsi dhe përball shkolles ka shkelur nenin 85.1 të LZP-së janë të paqëndrueshme pasi që me këto dispozita ligjore parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KKV-ve ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gejtur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.


Meqenë se koha për të cilën parashihet të aplikohet kjo dispozitë ligjore është 24 orë para votimit dhe gjatë ditës së votimit kurse ankesa është parashtruar gjatë fushatës zgjedhore, Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e parashtruesit të ankesës së është thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik KDTP, pasi që posterat në fjalë janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, pra në zyrat e subjektit politik KDTP, ashtu siç vërtetohet nga fotografit dhe CD-ja që gjenden në shkresat e lëndës.

Poashtu Paneli gjeti se edhe pretendimet e parashtruara me ankese se është shkelur neni 5.2 i Rregulles Zgjedhore 13/2013 janë të paqëndrueshme pasi që me këtë nen parashihet se cilat kategori nuk mund të përfshihen në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL. Anr.120/2017 më datën 06.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.